



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1616, datë 24.06.2011

Për

“Fillimin e procedimit administrative për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Albanian Mobile Communications sh.a dhe Plus Communication sh.a”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 24.06.2011, sipas procedurës së përcaktuar në Ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brëndshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Albanian Mobile Communications sh.a dhe Plus Communication sh.a

BAZA LIGJORE:

1. Neni 49, neni 50 pika 1 dhe neni 60 e vijues të Ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**Ligji nr. 9918**);
2. Neni 46 e vijues të Ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);
3. Rregullore nr. 18 “Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1296, datë 11.06.2010;
4. Rregullore nr. 19 “Për Aksesin dhe Interkoneksionin”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 1300, datë 14.06.2010 e ndryshuar;
5. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brëndshme të AKEP (**Rregullorja e Brëndshme**), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918,

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Shkresa e sipërmarrësit AMC sh.a me nr. 2136 prot, datë 29.04.2011 “Kërkesë për procedim administrativ lidhur me tarifën e terminimit të operatorit mobile Plus” (AKEP: 763 prot, datë 03.05.2011);
 - Relacion shpjegues mbi Projekt-Vendimin (*Relacioni*);
 - Korrespondenca me e-mail midis palëve,
 - si dhe,
- duke i’u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar.

V Ë R E N:

- I. AMC me shkresën nr.2136 prot, datë 03.05.2011 “Kërkesë për procedim administrativ lidhur me tarifën e terminimit të operatorit mobile Plus” sqaron se:
 1. AMC, në zbatim të akteve Vendimi nr. 1505, datë 10.02.2011 të Këshillit Drejtues të AKEP, si dhe në RIO-n e AMC, i kërkon Plus të lidhin marrëveshjen e interkoneksionit duke filluar nga data 01.03.2011, gjithashtu kërkon që në marrëveshjen e re të reflektoheshin tarifatat e reja të terminimit për të dy sipërmarrësit si dhe përditësimin e RIO;
 2. AMC pretendon se, Plus gjatë procesit të negociatave për kontratën e re të interkoneksionit nuk i ka pranuar kërkesat e ligjshme të AMC, duke argumentuar se Vendimi i AKEP për këtë çështje ka qënë udhëzuesi për qëndrimin e Plus;
 3. AMC, konsideron se Plus si një kompani që ushtron aktivitet tregtar në Republikën e Shqipërisë është e detyruar t’i nënshtrohet legjislacionit, proceseve rregullatore, zbatimit të rekomandime dhe Vendimeve të AKEP;
 4. AMC thekson se, Plus edhe pse nuk ka ende një status FNT, ka monopolin si të gjithë operatorët e tjerë në tregun e terminimit të thirrjeve në rrjetin e tij;
 5. Gjithashtu AMC sqaron se, AKEP i rekomandon Plus që të aplikojë tarifën e terminimit prej 15.93 lek duke filluar nga data 1.03.2011, dhe se nga aplikimi i tarifave të terminimit të propozuara nga AKEP, niveli i asimetrisë midis AMC dhe Plus duke filluar nga data 1.03.2011 rezulton të jetë 80%;
 6. AMC, thekson se asimetria aktuale e tarifave të terminimit midis AMC dhe Plus është në nivelin 114%, i cili është shumë më i lartë se niveli 80% i propozuar nga AKEP në Vendim nr. 1505, datë 10.02.2011 të KD;
 7. AMC konsideron se, nese vazhdohet të insistohet që Vendimi i AKEP për orientimin e tarifave në kosto është i vlefshëm vetëm për operatorët me status FNT në treg, atëhere kjo situat bie ndesh me parimin e reduktimit gradual të asimetrisë deri në eliminimin total të tyre brënda një harku kohor prej 4-5 vjetësh, siç është parashikuar nga AKEP;
 8. Për sa më sipër AMC vlerëson se, situata e krijuar bie ndesh me nenet 7, 31, 34, 37, 39 të Ligji nr. 9918 datë 09.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” si dhe të neneve 108 dhe 118 të Ligj nr. 8485 datë 12.05.1999 “Kodi i

procedurave Administrative” ndaj kërkon që Plus t’i nënshtrohet procesit rregullator dhe të ndjekë “glide- path”-in e rekomanduar nga AKEP për tarifat e tij të terminimit;

9. AKEP, për sa më sipër në zbatim edhe të nenit 50 të Ligjit nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” zgjidhja e mosmarrëveshjes midis sipërmarrësve mund të kryhet në bazë të kërkesës së një sipërmarrësi apo me inisiativën e AKEP,

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të Ligjit nr. 9918, nenin 46 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brëndshme,

V E N D O S:

1. Të fillojë procedimim administrativ, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis Albanian Mobile Communications sh.a dhe Plus Communication sh.a.;
 2. Të ngrihet komisioni për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me përbërje si:
 - Altin Rrapaj Kryetar
 - Jonida Gjika Anëtar
 - Përparim Buçaj Anëtar
 - Florida Çela Anëtar
 - Esmeralda Dervishi Anëtar
 3. Të njoftohen palët e interesuara Albanian Mobile Communications sh.a dhe Plus Communication për fillimin e procedimit administrativ;
 4. Palët të depozitojnë pretendimet e tyre me shkrim brenda 15 ditëve nga marrja e Vendimit;
 5. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al
- Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARË:

1. **Alketa MUKAVELATI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Ibsen ELEZI**
4. **Zamira NURCE**